



## PROGRAMI I BURSAVE POLAKE “STEFAN BANACH” 2021-2022

Agjencia Kombëtare e Shkëmbimit Akademik të Republikës së Polonisë, NAWA, ka shpallur hapjen e aplikimeve në kuadër të programit të bursave “Stefan Banach”. Përfitues të Programit do të jenë studentët e vitit të fundit në Bachelor, por edhe ata që i kanë përfunduar studimet e nivelit I jo më vonë se viti 2019. Afatet e aplikimit për këtë bursë janë jo më vonë se data **21 qershor 2021**, ora 3:00:00 pasdite me orën lokale Varshavë.

Ky program ofron studime të nivelit II me bursë 1500 PLN afro 335 EUR në muaj përgjatë gjithë vitit akademik (3-4 semestra). Studimet përfshijnë fushat e mëposhtme:

- a) shkencat inxhinieriko-teknike;
- b) shkencat agrare;
- c) shkencat ekzakte dhe ato të natyrës.

Opsionale mund të jenë edhe studime në shkencat humane dhe ato sociale ku bëjnë përjashtim studimet filologjike. Studimet mund të kryhen në gjuhën polake, ose angleze.

Për rastin e parë Programi parashikon edhe bursë për kursin 9-mujor, për mësimin e gjuhës polake (1700 PLN afro 379 EUR në muaj) si dhe kursin veror të gjuhës (1500 PLN afro 335 EUR) që ka në fokus studentët që kanë mbaruar vitin I në gjuhën angleze.

Niveli i njohurive të gjuhës polake për aplikantët duhet të jetë të paktën B1, ndërsa për gjuhën angleze së paku B2. Vlerësimi i aplikimeve do të ketë në bazë mesataren aritmetike të rezultateve në Bachelor.

Aplikimet do të bëhen **vetëm në formë elektronike përmes sistemit TIK të NAWA-s**, në gjuhën angleze dhe atë polake:

<https://programs.nawa.gov.pl/login>

Për më shumë informacion klikoni linkun e mëposhtëm:

<https://nawa.gov.pl/en/students/foreign-students/the-banach-scholarship-programme/call-for-proposals>

**DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS**